

NEPTUN Sh.p.k

**Pasqyrat financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(dhe raporti i audituesit të pavarur)**

1. Njësia raportuese

NEPTUN Sh.p.k, më poshtë “Shoqëria”, është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në datë 24 Shtator, 2001, me NUIS K12222001B, me një vlerë kapitali të paguar prej 100,000,000 Lek.

Objekti kryesor i veprimtarisë së Shoqërisë përfshin tregtimin, import-eksport dhe shitje me pakicë e shumicë të elektroshtepiakëve, etj, sipas objektit të përcaktuar në statutin e saj dhe të publikuar rregullisht në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Shoqëria ka në administrim 18 njësi shitje që ndodhen në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët:

- Balfin shpk zotërues i 90% të kuotave, që përbën 90% të kapitalit, në vlerën 90,000,000 Lek;
- Z. Julian Manë zotërues i 10% të kuotave, që përbën 10% të kapitalit, në vlerën 10,000,000 Lek.

Administratori i shoqërisë është Z. Alexandros Kosenas me afat emërimi deri më 29 Maj 2023.

Më 31 Dhjetor, 2022 Shoqëria kishte 452 të punësuar (31 Dhjetor 2021: 421 punonjës).

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Selia Brunes Space, Qendra Tregtare Tirana East Gate, Rruga Nacionale Tiranë - Elbasan, Farkë, Tiranë, Shqipëri.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 17 datë 16.01.2019, në mbështetje të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009, një subjekt mund të klasifikohet i rëndësishëm për interesin e publikut (NIP) për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre. Bazuar në pikën IV të këtij vendimi, Neptun klasifikohet si NIP si rrjedhojë e plotësimit të kriterëve.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 janë miratuar nga Administratori i Shoqërisë, Alexandros Kosenas më 25 Mars 2023.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Baza e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në “Lek”, e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

(d) Parimi i vijimësisë

Drejtimi i Shoqërisë ka bërë një vlerësim të aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët në dispozicion është besimplotë se Shoqëria zotëron burime financiare të mjaftueshme për të vazhduar veprimtarinë e saj për një të ardhme të parashikueshme. Për më tepër, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Si rrjedhojë, Pasqyrat Financiare vazhdojnë të përgatiten mbi parimin e vijimësisë.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**(e) Përdorimi i gjykimit dhe i vlerësimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i Shoqërisë të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që mund të ndikojnë në aplikimin e politikave si dhe vlerave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet kryesore janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë të ardhshme në të cilën mund të ketë ndikim.

Në veçanti, elementë të rëndësishme të pasigurive në vlerësim dhe gjykimeve kritike në zbatimin e politikave kontabël, të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përfshirë në shënimin 6 dhe në paragrafët e mëposhtëm:

- *Zhvlerësimi i pasurive jo-financiare (si referencë pika 3.5)*
- *Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve (si referencë pika 3.9)*
- *Tatimi mbi të ardhurat (si referencë pika 3.11)*
- *Aktive në përdorim dhe qiraja financiare (si referencë pika 3.12)*
- *Provizione (si referencë pika 3.13)*

3. Politika kontabël të rëndësishme**3.1 Transaksionë në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Të gjitha humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga rivlerësimi i zërave monetare në monedhe të huaj me kursin e këmbimit të fundit të vitit njihen në fitim ose humbje.

Zërat jo-monetare nuk rikëmben në fund të periudhës dhe maten me kosto historike (këmben duke përdorur kursin e këmbimit në datë kur është kryer transaksioni), përveç rasteve kur zërat jo-monetare maten me vlerë të drejtë, të cilat këmben duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të aplikuara (Lek kundrejt monedhave të tjera të huaja) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
EUR	114.23	120,76
USD	107.05	106,54

3.2 Aktivët afatgjata materiale**(i) Njohja dhe matja**

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka. Kostot historike përfshijnë shpenzimet të lidhura drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitetit. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë koston e materialeve dhe të punës së shpenzuar, si dhe çdo kosto tjetër që lidhet me sjelljen e aktivitetit në kushte punë për qëllimin për të cilin janë krijuar, kostot e çmontimit dhe zhvendosjes së aktivitetit dhe kthimit të vendit të punës ku aktiviteti ishte vendosur në gjendjen e tij fillestare dhe kostot e huamarrjes që lidhen me aktivitetin e kualifikuar për t'u kapitalizuar. Kur pjesë të ndryshme të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme të dobishme, ato kontabilizohen si pjesë më vete (komponentë kryesore) të aktiveve afatgjata materiale.

3. Politika kontabël të rëndësishme**3.2 Aktivët afatgjatë materiale***(ii) Kostot e mëpasshme*

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjatë materiale i shtohet vlerës së mbartur të aktivitetit vetëm në qoftë se parashikohet që kjo pjesë të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen për Shoqërinë dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve materiale afatgjatë njihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndërtesa	Metoda lineare	5%
Makineri dhe pajisje	Metoda lineare	10%
Mjete transporti	Metoda lineare	10%
Mobilje dhe orëndi	Metoda lineare	10%
Pajisje informatike	Metoda lineare	20%

Vlera e mbetur e një aktivi është shuma e vlerësuar që Shoqëria do të përfitojë nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktivitetit minus kostot e vlerësuar për ta nxjerrë jashtë përdorimit, në qoftë se aktivi është tashmë në moshën dhe në kushtet e pritshme në fund të jetës së tij të dobishme. Vlera e mbetur e aktivitetit dhe jeta e dobishme rishikohen, dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në fund të çdo periudhe raportimi.

3.3 Aktivët afatgjatë jo-materiale

Aktive afatgjatë jo-materiale të Shoqërisë përfshijnë kryesisht sisteme informatike, platforma WEB, licenca përdorimi të sistemeve etj. Aktivët afatgjatë jo-materiale të blera nga Shoqëria paraqiten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (nëse ka), bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar pas datës së cilës ato janë të gatshme për përdorim. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjatë jo-materiale shqyrtohet në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh në periudhat e ardhshme.

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Aktive afatgjatë jo materiale	Metoda lineare	10%

3.4 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabel e një aktivi ose njësisë gjeneruesë të mjeteve monetare është më e vogël se vlera e tij e rikuperueshme. Një njësi gjeneruesë e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshem i aktiveve që gjeneron fluksë monetare në menyrë të pavarur nga aktivët apo grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruesë të mjeteve monetare është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme skontojnë për ti sjellë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivitetit. Në lidhje me aktivët e tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret në qoftë se ka ndonjë tregues që ky zhvlerësim nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerat e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në masën që vlera kontabël e aktivitetit nuk e kalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, në qoftë se asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk është njohur.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.5 Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes.

Kostot e inventarit përcaktohen duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar, e cila përfshin të gjitha kostot e blerjes, transportit, tarifat doganore dhe sigurimit gjatë transportit, kostot e konvertimit dhe çdo kosto tjetër që lidhet me inventarin për të sjellë atë në vendin dhe kushtet e punës.

Në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, Shoqëria vlerëson nevojën për zhvlerësim të inventarit për produktet të vjetëruara dhe produktet e pariparueshme.

Produktet e tregtueshme zhvlerësohen sipas vjetërsisë bazuar në normat e provizionimit të vlerësuar nga grupi në nivel industrie si edhe nga faktorë të ndryshëm në datën e zhvlerësimit.

Produktet gjendje në magazinën e riparimit zhvlerësohen bazuar mundësinë e kalimit në inventar të tregtueshëm referuar të dhënave historike të dy viteve të fundit të lëvizshmërisë së produkteve në këtë magazinë.

Produktet e vlerësuara si të pa-riparueshme nga kompania e çertifikuar e servisit, zhvlerësohen me normën 100%.

Shuma e zhvlerësimit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse atëhere kur ka faktorë objektive që tregojnë që inventarët janë zhvlerësuar.

3.6 Instrumentet financiare

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose një instrument kapitali të një njësie ekonomike tjetër.

Aktiv Financiar

(i) Njohja dhe matja fillestare

Aktivët financiarë klasifikohen, në njohjen fillestare, siç maten më pas me koston e amortizuar, vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) dhe vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

Shoqëria fillimisht mat një aktiv financiar në vlerën e tij të drejtë plus, në rastin e një aktivi financiar jo me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit. Të arkëtueshmet tregtare që nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi ose për të cilin Shoqëria ka aplikuar përshtatshmërinë praktike maten me çmimin e transaksionit të përcaktuar në SNRF 15.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), ai duhet të krijojë flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar. Ky vlerësim referohet si testi SPPI dhe kryhet në një nivel instrumenti. Në datën e raportimit, Shoqëria nuk mban aktive financiare me flukse parash që klasifikohen SPPI.

Modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si këto administrohen në mënyrë që të gjenerojë flukse parash. Modeli i biznesit përcakton nëse flukset e parave do të rezultojnë nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale, shitja e aktiveve financiare ose të dyja. Modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare bazohet në mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.6 Instrumentet financiare

(ii) Klasifikimi dhe matja vijuese

Për qëllime të matjes vijuese, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktive financiare me kosto të amortizuar (instrumente borxhi);
- Aktive financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit);
- Aktive financiare të përcaktuara me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) pa riciklim të fitimeve dhe humbjeve kumulative gjatë çregjistrimit (instrumentet e kapitalit);
- Aktive financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

Shoqëria mban aktive financiare të kategorisë së parë, aktive financiare me kosto të amortizuar (instrumente borxhi). Aktivet financiare me kosto të amortizuar më pas maten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe janë subjekt i zhvlerësimit. Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktiviteti çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet. Aktivet financiare të Shoqërisë me kosto të amortizuar përfshijnë llogari të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera dhe ekuivalentet e mjeteve monetare.

(iii) Fshirja

Aktivitetet financiare janë shlyer, tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka shteruar të gjitha përpjekjet praktike për arkëtim dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka ndonjë pritje të arsyeshme të rikuperimit. Fshirja përfaqëson një çregjistrim. Shoqëria mund të fshijë aktivet financiare që janë ende subjekt i veprimtarisë së arkëtimit kur Shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që i detyrohen sipas kontratës, por megjithatë, nuk ka pritje të arsyeshme të rikuperimit.

(iv) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktiviteti financiar, ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parave në një transaksion në të cilin janë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar janë transferuar ose në të cilën Shoqëria as transferon, as ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar.

Shoqëria hyn në transaksione me të cilat transferon aktivitetet e njohura në pasqyrën e pozicionit të saj financiar, por ruan ose të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në këto raste, pasuritë e transferuara nuk çregjistrohen.

Detyrimet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, hua dhe huazime, pagesa të pagueshme, ose si derivativë të përcaktuar si instrumente mbrojtës në një mbrojtje efektive, siç është e përshtatshme.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe huazimeve dhe të pagueshme, neto nga kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë llogari të pagueshme tregtare dhe të pagueshme të tjera dhe hua.

(ii) Klasifikimi dhe matja pasuese

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- Detyrimet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- Detyrimet financiare me kosto të amortizuar (hua dhe huazime).

Shoqëria nuk klasifikon asnjë pasiv financiar në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.6 Instrumentet financiare

Detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Çregjistrimi

Një pasiv financiar çregjistrohet kur detyrimi në pasiv shkarkohet ose anulohet ose skadon.

Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivitet dhe pasivitet financiar janë kompensuar dhe shuma neto është raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e zbatueshme nga ligji për të kompensuar shumën e njohura, dhe ekziston një qëllim që ose të shlyhet në një bazë neto, ose të realizohet aktivi dhe shlyhet detyrimin njëkohësisht. Një e drejtë e tillë e shlyerjes (a) nuk duhet të varet nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë e zbatueshme ligjërisht në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast të mospagimit dhe (iii) në rast të paaftësisë paguese ose falimentimi.

3.7 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar konsiston në mjetet monetare të kontribuara nga themeluesit e Shoqërisë. Kapitali aksionar paraqitet me vlerën në Lek të konvertuar me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerë nominale.

3.8 Njohja e te ardhurave

Sipas SNRF 15 të ardhurat njihen në masën që është pothuajse e sigurt se një kthim në sasinë e të ardhurave të akumuluar të njohura nuk do të ndodhë. Kështu e ardhura matet duke u bazuar në shumën e përcaktuar në një kontratë me klientin ose në listën e çmimeve të Shoqërisë. Shoqëria e njeh te ardhurën atëherë kur ajo transferon kontrollin mbi shërbimin ose mallin tek klienti.

Shoqëria njeh të ardhurën kur kontrolli i mallrave ose shërbimeve transferohet tek klienti në një shumë që reflekton shumën që Shoqëria pret në këmbim të transfertës të këtyre mallrave ose shërbimeve për një klient.

Shoqëria përgjithësi ka arritur në përfundimin se ajo është kryesori në të gjitha marrëveshjet e të ardhurave, sepse zakonisht kontrollon mallrat ose shërbimet përpara transferimit të tyre tek klienti.

Me përjashtim të ardhurave nga garancite, transporti, montimi dhe riparimit ku luan rolin e agjentit.

Të ardhurat kryesore nga kontratat me kliente janë si më poshtë:

Të ardhura nga shitja e produkteve

Shoqëria është e angazhuar me shitjen e artikujve të ndryshëm elektroshtepiakë me pakicë dhe shumicë. Këto produkte faturohen mbi bazën e një liste çmimesh të përcaktuar.

- Shoqëria njeh të ardhurat nga shitjet me pakicë në një moment në kohe kur kontrolli i mallrave kalohet tek klienti, zakonisht në pikën e shitjes dhe operon me pagesë të menjëhershme në momentin e dorëzimit të produktit tek klienti.
- Shoqëria njeh të ardhurat nga shitjet me shumicë në një moment në kohë kur mallrat dorëzohen tek klienti sipas kushteve të kontratës mes palëve dhe operon me pagesë të menjëhershme dhe/ose me terma pagese që zgjasin nga 30 ditë në 45 ditë pas dorëzimit.

Të ardhurat e mësipërme llogariten në bazë të numrit të artikullit të shitur, listës së çmimeve të paracaktuar dhe njihen në pasqyrën e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse kur ndodhin. Shoqëria njeh shitjet në momentin e transferimit të produkteve tek klienti, pra kur të gjitha përfitimet dhe rreziqet e produktit si dhe kontrolli mbi produktin i kalojnë klientit.

Shoqëria u ofron klienteve zbritje nga promocione të ndryshme. Shoqëria njeh këto zbritje menjëherë me shitjen e produkteve.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.8 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Të ardhura nga shitja e produkteve (vazhdim)

Shoqëria shqyrton nëse ka premtime të tjera në kontratë që kanë performancë të veçantë në detyrimet për të cilat duhet të ndahet një pjesë e çmimit të transaksionit (p.sh garancitë, transport, montime e pikë besnikërie të klientit). Shoqëria nuk shet paketa produktesh.

Të ardhura nga Garancitë

Shoqëria zakonisht së bashku me produktin jep garanci standarte që varion nga 12-24 muaj për riparimet e difekteve që ekzistojnë në kohën e shitjes të cilën e ka të transferuar nga furnitori dhe prodhuesi saj. Këto garanci nuk shiten vecmas nga çmimi i përcaktuar i produktit, si rrjedhojë Shoqëria ka gjykuar që nuk ka një detyrim kontraktual më vete dhe është në rolin principal në realizimin e të ardhurave nga garancitë standarte.

Shoqëria gjithashtu ofron garanci shtesë produktet të specifikuar për klientët e saj. Këto garanci të llojit të shërbimit shiten vecmas me çmimin e përcaktuar sipas vlerës së produktit që mbulohet. Shoqëria ka gjykuar që është agjent në realizimin e të ardhurave nga garancitë pasi të gjithë detyrimin ndaj klientit e ka transferuar të shoqëria përgjegjëse për riparimin.

Shoqëria njeh të ardhurat nga shërbimet e garancisë, të cilat netohen me shpenzimet përkatëse të garancive. Duke qënë se Shoqëria është agjent njeh të ardhurat në një moment në kohë kur ndodh shitja ndaj klientit dhe pagesë e tarifës ndaj Shoqërisë së autorizuar për riparim.

Të ardhura nga shërbimet e transportit

Shoqëria mundëson shërbimet transportit të produkteve të saj tek klientët ose nga Shoqëri të autorizuar prej saj dhe/ose prej partnerëve të saj për transport të produkteve. Këto të ardhura nuk janë materiale për Shoqërinë.

Shoqëria ka gjykuar që është agjent pasi kryesisht shërbimi transportit ofrohet nga palë të treta dhe detyrimi performancës mbetet të palet e treta.

Të ardhurat nga shërbimi transport njihen duke i netuar me koston e shërbimit dhe njihen në një moment në kohë kur malli dorëzohet tek transportuesi.

Të ardhura nga shërbimet e montimeve

Shoqëria ofron shërbime të montimit të produkteve klientëve si shërbim i vecantë në rolin e agjentit duke qënë se detyrimin e performancës të këtij shërbimi e ka transferuar në një shoqëri të autorizuar prej saj. Këto të ardhura nuk janë materiale për Shoqërinë.

Shoqëria njeh të ardhurat nga shërbimi i montimit duke i netuar me koston e shërbimit dhe i njeh ato në një moment në kohë kur kryhet shërbimi nga pala e autorizuar.

Programi besnikërisë

Shoqëria u ofron klientëve zbritjen nga Programi i Besnikërisë së Klientit "Happy" i cili është një program i zbatuar nga Balfin Group dhe 4 kompani si anëtarë. Çdo klient, i pajisur me Happy Card, grumbullon pikë për çdo blerje në çdo dyqan të anëtarëve. Klienti ka dy opsione në konvertimin e këtyre pikave në kupona

Kur klienti arrin 5,000 pikë (të grumbulluara për blerjet e bëra në cilindo nga anëtarët), klientit i jepet opsioni për t'i kthyer pikët në kupona me vlerë totale 3,000 lekë ose mund të vazhdojë të grumbullojë pikë deri në 10,000 pikë dhe automatikisht i konvertohen në kupona me vlerë totale 6,000 lekë.

Shoqëria zbritjen nga kuponat e përdorur nga klientët në vlerën 500 lek për nivelin e parë dhe 4,000 lek për nivelin e dytë me kushtin që blerja të jetë me vlerë më të madhe se 20,000 lek i njeh menjëherë me blerjen e produkteve.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.8 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Nëse pikët nuk shfrytëzohen brenda afatit, Shoqëria do të njoh si të ardhura pikët e mbledhura por të papërdorura. Bazuar në skemën e programit kostot shpërndahen nga On Solution shpk ("Banker") ndërmjet anëtarëve sipas pikeve specifike të gjeneruara prej tyre.

Kjo e fundit ka lidhur një kontratë me anëtarët, sipas së cilës secilit prej anëtarëve do t'i faturohen pikët e akumuluar nga shitja e produkteve në biznesin e tyre (të përcaktuara si të ndryshme për secilin anëtar) dhe do të rimbursojë çdo kosto të shkaktuar kur shlyen kuponët në vlerën e tyre nominale.

Shoqëria nuk mban përgjegjësi ndaj klientit për pikët e akumuluar dhe të pa shfrytëzuara dhe në këtë mënyrë Shoqëria nuk njeh detyrim kontrate për pikët e akumuluar të papërdura duke qënë së këto pikë janë përfshirë nga Banker në detyrimet mujore. Banker do faturojë shoqëritë për pikët të dhëna.

Në pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse vlera akumuluar nga pikët e dhëna paraqitet si zbritje nga të ardhurat.

Të ardhura nga tarifa me partnerët franchise

Shoqëria përfiton nga partnerët Franchise të ardhura sipas kontratëve për tarifën në përqindje në bazë të shitjeve mujore që realizojnë për produktet që Neptun u tregton, si edhe nga tarifat për përdorimin e emrit, e cila llogaritet në bazë të përqindjeve të dakordësuara në kontratë të cilat faturohen në baza mujore ose 3-mujore.

Sipas kontratës partneri Franchise mund të blejë produkte nga Shoqëria sipas çmimeve të ofruara paraprakisht me terma pagesash prej 45 ditësh kundrejt një garancie bankare të lëshuar nga ana e partnerit në favor të Shoqërisë. Partnerët franchise nuk kanë të drejta kthimi në kontratat e tyre.

Referuar kushteve të mësipërme dhe Standartit SNRF 15 Shoqëria njeh të ardhurat e saj në momentin e faturimit, pasi pronësia së bashku me risqet dhe ekskluzivitetin e përdorimit të produkteve dhe emrit kalon tek klienti. Gjithashtu Shoqëria nuk ka risqe të mundshme financiare për arkëtimin e të drejtave të arkëtueshme pasi mund të shfrytëzojë garancinë bankare të lëshuar në favor të saj.

Të ardhura të tjera nga komisionet e ndërmjetësimit

Neptun mundëson për klientet e vet financime duke përfituar pagesa me këste për produkte të blera në Neptun nga institucione të ndryshme të kreditit si: Raiffeisen Bank, IUTE, Banka Kombetare Tregtare. Për të gjitha kreditë që lidhen në dyqanet Shoqëria përfiton një komision nga bankat e cila përcaktohet në marreveshjet përkatëse.

Shoqëria është agjent në këto marrëveshje financimi të klientëve dhe njeh të ardhurat vetëm në masën e komisionit të ndërmjetësimit në një moment në kohë. Shoqëria arkëton drejtpërdrejt nga institucioni financiar vlerën e mallit të shitur plus komisionin e ndërmjetësimit. Termat e pagesës nga këto institucione financiare variojnë nga 1 deri në 3 muaj.

Të ardhura nga shërbimet e riparimeve

Neptun në rolin e agjentit mundëson shërbimin e riparimit produkteve të saj nëpërmjet Shoqërive të autorizuar prej saj dhe/ose prej partnerëve të saj. Neptun njeh të ardhurat nga shërbimi i riparimit duke i netuar me koston e shërbimit. Të ardhurat njihen në një moment në kohë kur produkti i riparuar tërhiqet nga klienti. Pagesa ndodh në momentin e marrjes së produktit të riparuar.

Shuma korresponduese e ndryshueshme

Shoqëria ofron zbritje në bazë të volumeve të shitura për disa nga klientët e saj më të mëdhenj bazuar në volumet e shitjeve. Sipas SNRF-ve, zbritjet e volumit njihen si shuma korresponduese të ndryshueshme dhe zbriten nga të ardhurat e vitit.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.9 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurime shoqërore

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, Shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të punonjësve për pjesën që ligjerisht i takon të paguajë Shoqërisë dhe punonjesve për të kontribuar për fondet e detyrueshme të pensioneve sipas rregullimeve të legjislacionit vendas. Kostot e Shoqërisë janë përfshirë në llogaritjen e rezultatit të periudhës.

3.10 Tatim fitimi i vitit dhe tatim fitimi i shtyrë

Shpenzimet për tatim fitimin përfshijnë tatim fitimin aktual dhe tatim fitimin e shtyrë. Shpenzimet për tatim fitimin njihen në fitim ose humbje deri përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

Shpenzimet për tatim fitimin përfshijnë tatim fitimin aktual dhe tatim fitimin e shtyrë. Shpenzimet për tatim fitimin njihen në fitim ose humbje deri përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse. Tatimi mbi fitimin aktual është tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme duke përdorur normat e taksimit në datën e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm të lidhur me vitin e kaluar.

Tatim fitimi i shtyre njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë, duke u bazuar në ligjet që kanë qënë ose janë në fuqi në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të mbuluar diferencat e përkohshme. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në qoftë se përfitimet tatimore nuk do të jenë më të mundshme për tu realizuar.

3.11 Aktive në përdorim dhe qiraja financiare

Shoqëria merr me qira dyqane të cilat shërbejnë si pika shitje, vënde magazinimi të produkteve, hapësira administrative për punonjësit si dhe automjete etj.

i. Aktiv me të drejtë përdorimi

Shoqëria njeh një aktiv me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë (p.sh. data kur aktivi është i gatshëm për përdorim). Aktivi me të drejtë përdorimi matet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi dhe ndonjë korigjim për rimatjet e detyrimit të qirasë.

Kosto e aktivit me të drejtë përdorimi përfshin:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë së njohur
- çdo pagesë e kryer në ose para datës së fillimit të qirasë, pa përfshirë çdo incentivë të përfituar
- çdo kosto fillestare direkte, dhe
- kostot për kthimin e aktivit në kushtet e kërkuara nga marrëveshjet e qirasë

Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet me metodën lineare për periudhën më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Nëse aktivi me qira transferohet në pronësi të Shoqërisë në fund të periudhës së qirasë ose kosto reflekton opsionin e blerjes, amortizimi llogaritet me jetëgjatësinë e dobishme të aktivit. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtë përdorimi që lidhen me pikat e shitjes dhe/ose magazinimi, hapësira administrative (zyra) dhe automjetet llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë afatit të përcaktuar të qirasë.

Pika shitje dhe/ose magazinimi
Automjete
Hapësira administrative (zyra)

Jeta e dobishme në vite
1 deri në 10 (me të drejtë rinovimi)
1 deri në 5
5

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**3.11 Aktive në përdorim dhe qiraja financiare (vazhdim)***ii. Detyrimi i qirasë*

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njih një detyrim të qirasë së matur me vlerën aktuale të pagesave të qirasë përgjatë periudhës së qiramarrjes.

Pagesat e qirasë përfshijnë:

- pagesat fikse (përfshirë pagesat fikse në-thelb), minus çdo stimul qiraje të marrë;
- pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit;
- shumat e pritshme për t'u paguar nga qiramarrësi sipas vlerës së mbetur të garancive;
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë opsion, dhe;
- pagesat e gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë reflekton ushtrimin nga qiramarrësi të një opsioni për përfundimin e qirasë;

Në vlerën aktuale të pagesave të qirasë, shoqëria përdor normën rritëse të qiramarrjes në datën e fillimit të qirasë, sepse norma e implicite e qirasë nuk është e mundur të përlogaritët. Pas datës së fillimit vlera e detyrimit të qirasë rritet duke reflektuar interesin e përlogaritët dhe zvogëlohet me pagesat e qirasë. Vlera kontabël e detyrimit të qirasë do të rishikohet nëse ka ndonjë modifikim, ndryshim afati, ndryshim pagese ose një ndryshim në vlerësimin e opsionit të blerjes së aktivitet.

Normat e interesit janë llogaritët nga normat mesatare të huamarrjes nga shoqëritë e Grupit sipas fashave të jetgjatësisë së kontratave:

	1-2 vite	3-5 vite	6-10 vite	10-15 vite	mbi 15 vite
Lekë	6%	6%	6.50%	6.50%	6.50%
Euro	4.5%	5%	5.70%	5.5%	6%

Pagesat që lidhen me qira afatshkurtra dhe të gjitha qiratë e aktiveve me të drejtë përdorimi me vlerë të ulët njihen në bazë lineare si një shpenzim në pasqyrën e fitimeve ose humbje. Qiratë afatshkurtra janë qira me afat prej 12 muajsh ose më pak se 12 muaj. Aktivët me vlerë të ulët janë aktive me një vlerë prej 5,000 Euro ose më pak se 5,000 Euro.

Shoqëria si qiradhënëse

Qiratë në të cilat Shoqëria nuk i transferon të gjitha risqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e aktivitet janë klasifikuar si qira operacionale. Të ardhurat nga qiraja kontabilizohen me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së qirasë dhe përfshihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas natyrës së operacionit. Kostot fillestare direkte gjatë negociimit dhe caktimit të një qiraje operacionale i shtohen vlerës kontabël të aktivitet të dhënë me qira dhe njihen përgjatë jetëgjatësisë së qirasë sipas së njejtës metodë. Qiratë e kushtëzuara njihen si të ardhura në periudhën që ato përfitohen.

3.12 Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin dhe kur një vlerësim i besueshëm i vlerës së detyrimit mund të bëhet nëse efekti është material, provigjonet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhshme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe kur është e nevojshme rrezikun specifik të detyrimit. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më e mundshme që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin, provigjoni anulohet. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhme operative. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në kontabilitet.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.12 Provizionet (vazhdim)

Provizione për çështje gjyqësore

Neptun nuk ka njohur një provizion në pasqyrat financiare të vitit 2022 për çështje gjyqësore.

Provizione për zhvlerësim inventari

Shoqëria ka njohur një provizion në pasqyrat financiare të vitit 2022 për zhvlerësim inventari. Në llogaritjen e provizionit për zhvlerësim të inventarëve, inventarët grupohen në bazë të kategorive individuale.

Inventarët që lidhen me një linjë produkti që prodhohen me përdorim ose qëllim të njëjtë ose të ngjashëm dhe që do të ishte e vështirë të vlerësoheshin veçmas nga zërat e tjerë, kontabilizohen në bazë të përgjithshme për provizionin e zhvlerësimit të inventarëve.

Çdo rritje e shumës së provizionit për zhvlerësimin e inventarëve do të njihet në fitim ose humbje për periudhën aktuale. Çdo ulje e shumës së provizionit për zhvlerësimin e inventarëve do të njihet në fitim ose humbje për periudhën aktuale.

Provizione për garanci

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria i shet produktet e veta me garanci performance, në të njëjtën mase kohë me garancinë e ofruar nga prodhuesi. Në rast defekti, Shoqëria ka detyrim si më poshtë:

- Të riparojë produktin duke furnizuar pjesët e këmbimit dhe të mbulojë kostot e shërbimit të riparimit, ose
- Të zëvendësojë produktin me një produkt të ri.

Në përmbushjen e këtij detyrimi, Shoqëria:

- Merr furnizim pa kosto shtesë nga prodhuesi të pjesëve të këmbimit.
- Furnizuesi mund të rimbursojë dhe kostot e shërbimit të riparimit.

Për gjithë rastet e tjera kur nuk ka garanci nga furnizuesi, Shoqëria ka lidhur marrëveshje me Shoqëri të autorizuar për riparimin e produkteve. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, detyrimi i mirëmbajtjes i transferohet plotësisht Shoqërisë së autorizuar për riparim. Meqënëse përgjegjësia ligjore mbetet tek Shoqëria, ajo vlerëson vazhdimisht nëse shoqëritë e autorizuar për riparime do të mund të përmbushin obligimin e saj kundrejt klientëve dhe nuk ka identifikuar raste të tilla si rrjedhojë Neptuni nuk ka krijuar ndonjë provizion shtesë për përmbushjen e garancive.

3.13 Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjete monetare përfshijnë mjete monetare në arkë, llogari rrjedhesë në banka dhe mjete të tjera likuide me maturitet jo më shumë se tre muaj të cilat janë subjekt i ndryshimeve jo-sinjifikative në vlerën e tyre të tregut dhe që përdoren nga Shoqëria në manaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetet monetare mbahen në vlerën e tyre të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

3.14 Huamarrjet

Huatë janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë, neto nga kostot e hasura të transaksionit dhe në vazhdim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.15 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionare dhe drejtorët e Shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e Shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.16 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e Shoqërisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese) janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

4. Miratimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara

(i) Standardet të publikuara që janë të aplikueshme

Politikat kontabël të miratuara janë në përputhje me ato të vitit financiar të mëparshëm, me përjashtim të ndryshimeve të mëposhtme të SNRF-ve më 1 janar 2022.

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivet afatgjata materiale, objektet dhe pajisjet; SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet Kontingjente si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 (Ndryshime)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022 me aplikim të mëhershëm të lejuar. BSNK ka nxjerrë ndryshime me qëllim të ngushtë në Standardet SNRF si më poshtë:

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Ndryshimet)** përditësojnë një referencë në SNRF 3 për Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar pa ndryshuar kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit.
- **SNK 16 Aktivet afatgjata materiale, objektet dhe pajisjet (Ndryshimet)** e ndalojnë një Shoqëri të zbresë nga kostoja e aktiveve afatgjata materiale shumat e marra nga shitja e artikujve të prodhuar ndërkohë që Shoqëria po përgatit aktivin për përdorimin e synuar. Në vend të kësaj, një Shoqëri njeh të ardhurat e tilla nga shitjet dhe kostot përkatëse në fitim ose humbje.
- **SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Aktivet Kontingjente (Ndryshimet)** përcaktojnë se cilat kosto përfshin një Shoqëri në përcaktimin e kostos së përmbytjes së një kontrate me qëllim të vlerësimit nëse një kontratë është e rëndë.
- **Përmirësimet vjetore 2018-2020** bëjnë ndryshime të vogla në SNRF 1 Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNK 41 Bujqësia dhe shembujt ilustrues që shoqërojnë SNRF 16 Qiratë

(ii) Standardet dhe amendamentet e lëshuara por jo ende efektive dhe të pa miratuara më herët

Standardet dhe ndryshimet e mëposhtme do të miratohen nga Shoqëria kur të hyjnë në fuqi, megjithatë, këto nuk do të kenë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i pasiveve si korrente ose afatgjata (Ndryshime)**

Ndryshimet fillimisht ishin efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me aplikimin e mëhershëm të lejuar. Megjithatë, në përgjigje të pandemisë Covid-19, Bordi ka shtyrë datën e hyrjes në fuqi me një vit, pra 1 janar 2023, për t'u dhënë Shoqërive më shumë kohë për të zbatuar çdo ndryshim klasifikimi që rezulton nga ndryshimet. Ndryshimet synojnë të nxisin konsistencën në zbatimin e kërkesave duke ndihmuar Shoqëritë të përcaktojnë nëse, në pasqyrën e pozicionit financiar, borxhi dhe detyrimet e tjera me një datë të pasigurt shlyerjeje duhet të klasifikohen si rrjedhëse ose afatgjata.

4. Miratimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara (vazhdim)

- **SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare dhe Deklarata e praktikës SNRF 2: Shpalosja e politikave kontabël (Ndryshimet)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 me aplikim të mëhershëm të lejuar.

- **SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshime)**

Ndryshimet hyjnë në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 me aplikimin më të hershëm të lejuar dhe zbatohen për ndryshimet në politikat kontabël dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe.

- **SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshime)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 me aplikim të mëhershëm të lejuar. Në maj 2021, Bordi nxori ndryshime në SNK 12, të cilat ngushtojnë objektin e përjashtimit të njohjes fillestare sipas SNK 12 dhe specifikojnë se si Shoqëritë duhet të llogarisin për tatimin e shtyrë për transaksione të tilla si qiratë dhe detyrimet e çmontimit

- **16 Qiratë: Detyrimi i qirasë në një shitje dhe kthim me qira (ndryshime)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024, me aplikim të mëhershëm të lejuar. Ndryshimet synojnë të përmirësojnë kërkesat që përdor një shitës-qiramarrës në matjen e detyrimit të qirasë që lind nga një transaksion shitje dhe kthimi me qira në SNRF 16, ndërkohë që nuk ndryshon kontabilitetin për qiratë që nuk lidhen me transaksionet e shitjes dhe të marrjes me qira.

Shoqëria parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimet dhe interpretimet nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar

5.1 Faktoret e rrezikut financiar

Aktivitetet e Shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit.

Menaxhimi i rrezikut të Shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të Shoqërisë. Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar në politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut, si dhe çështje specifike, si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normes së interesit, rreziku i kreditit dhe investimi i likuiditetit të tepert.

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.2 Rreziku i tregut

Rreziku i kursit te kembimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut te kursit te kembimit që vjen si rezultat i ekspozimit në monedha te ndryshme kryesisht në lidhje me Euro-n. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për tu mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur pozicionë neto të përshtatshme në çdo monedhë dhe të monitorojë operacionet e përditshme. Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj në 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 është si më poshtë:

Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

31 dhjetor 2022	EUR	USD	LEK	Total
Aktivet financiare				
Të drejta të arkëtueshme	21.648.525	-	376.528.142	398.176.667
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	2.304.209	33.913	7.553.059	9.891.181
Të arkëtueshme të tjera	27.522.402	10.496.596	20.405.554	58.424.552
Mjete monetare dhe të ngjashme	5.849.847	2.983.410	85.881.909	94.715.166
	57.324.982	13.513.919	490.368.665	561.207.566
Detyrime financiare				
Huatë nga institucionet financiare	505.221.513	-	-	505.221.513
Detyrime për qiratë	782.068.310	-	56.096.026	838.164.336
Furnitorë dhe të tjera detyrime	525.917.699	47.010.977	76.230.984	649.159.660
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	481.591.490	81.893	53.795.567	535.468.950
Të pagueshme ndaj punonjësve	-	-	13.628.936	13.628.936
	2.294.799.012	47.092.870	196.300.373	2.538.192.255
Pozicioni neto	(2.237.474.031)	(33.578.951)	294.068.292	(1.976.984.689)
31 Dhjetor 2021	EUR	USD	LEK	Total
Aktivet financiare				
Të drejta të arkëtueshme	26.729.080	6.236.463	265.236.760	298.202.303
Të arkëtueshme nga palet e lidhura	504.628	-	6.425.683	6.930.311
Të arkëtueshme të tjera	-	-	27.303.380	27.303.380
Mjete monetare dhe të ngjashme	59.195.854	57.979.246	88.349.941	205.525.041
	86.429.562	64.215.709	387.315.764	537.961.035
Detyrime financiare				
Huatë nga institucionet financiare	305.586.940	-	3.595.196	309.182.136
Detyrime për Qiratë Financiare	475.654.459	-	-	475.654.459
Furnitorë dhe të tjera detyrime	1.273.360.479	118.253.603	77.561.223	1.469.175.305
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	2.862.781	216.286	43.212.428	46.291.495
Të pagueshme ndaj punonjësve	-	-	8.122.000	8.122.000
	2.057.464.659	118.469.889	132.490.848	2.308.425.396
Pozicioni neto	(1.971.035.097)	(54.254.180)	254.824.916	(1.770.464.361)

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.3 Rreziku i kredisë

Risku i kreditimit është risku humbjeve financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë që mban një instrument financiar nuk përmbush detyrimet kontraktuale, dhe kryesisht lindin nga të drejtat e arkëtueshme të Shoqërisë nga Klientet.

Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është perfaqësuar nga vlerat kontabël të çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar të përmbledhura si më poshte:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të drejta të arkëtueshme	398.176.667	298.202.303
Mjete monetare ne banka dhe ekuivalente të tyre	94.715.166	205.525.041

Ekspozimi nga risku i kredisë për të drejtat e arkëtueshme të Shoqërisë me 31 dhjetor 2021 është sipas matricës të provigjionit e cila paraqitet paraqitet si më poshtë për vitin 2021:

	0-30	31-60	61-90	Mbi 90 dite	Total
Norma e humbjeve të pritshme	6.51%	10.03%	3.17%	15.79%	45.10%
Shuma e të drejtat të arkëtueshme e vlerësuar për humbje	14.629.764	1.997.106	2.103.223	4.825.640	53.664.485
Humbja të pritshme e të drejtat të arkëtueshme	951.735	200.250	66.623	762.077	24.202.460

5.4 Politikat e fshirjes nga pasqyrat financiare

Vlera bruto e të drejtave të arkëtueshme fshihet nga pasqyrat financiare nëse Shoqëria vlerëson se nuk ka pritje të arsyeshme të rikuperimit të aktivitetit financiar në teresi ose pjesë e tij. Vendimi për fshirjen nga pasqyrat financiare të të drejtave të arkëtueshme merret në baze të një analize të shkaqeve si me poshte: Klienti është klasifikuar si problematikë dhe Shoqëria nuk ka arsye pritje të arsyeshme të rikuperimit të vlerës;

- Klienti është më shumë se 360 ditë në vonesë;
- Klienti është në vështirësi të thella financiare dhe nuk ka pritshmëri për arkëtueshmërinë e tyre.

Shoqëria nuk pret ndonjë rekuperim të konsiderueshëm të shumave të fshira. Megjithatë, vlerat e fshira mund të jenë sërish subjekt i përpjekeve për arkëtim.

5.5 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të vihet në vështirësi për të përmbushur detyrimet kontraktuale që lidhen me detyrimet financiare që shlyhen në para ose nëpërmjet një aktivi tjetër financiar. Qasja e Shoqërisë ndaj administrimit të likuiditetit është e tillë që të sigurojë, sa të jetë e mundur që do të ketë mjaftueshëm likuiditet për të shlyer detyrimet e saj kur të maturohen, në kushte normale dhe nën shtypje nga faktorët e tregut, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose të rrezikojë reputacionin e Shoqërisë.

Në vijim janë afatet e maturimit të kontratave të detyrimeve financiare në datën e raportimit.

31 dhjetor 2022	deri 3 muaj	3 - 12 muaj	deri 3 muaj	3 - 12 muaj	deri 3 muaj
Huatë nga institucionet financiare	434.567.692	70.653.821	-	-	505.221.513
Detyrime për qiratë financiare	45,313,472	135,940,416	189,744,924	467,165,525	838,164,337
Furnitorë dhe detyrime të tjera	609.668.667	22.816.250	16.674.742	-	649.159.659
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	532,017,810	-	-	-	532,017,810
Të pagueshme ndaj punonjësve	-	13,628,936	-	-	13,628,936
Totali	1,621,567,642	243,039,423	206,419,666	467,165,525	2,538,192,255

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.6 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Hendeku i likuiditetit deri në 3 muaj mbulohet nga shitjet, të cilat në çdo tre-mujor tejkalojnë në masë të madhe gjendjen mesatare të llogarive të pagueshme.

Me 31 dhjetor 2021	deri 3 muaj	3 - 12 muaj	1 - 2 vjet	Mbi 2 vjet	Totali
Huatë nga institucionet financiare	13.742.171	295.439.965	-	-	309.182.136
Detyrime për Qeratë Financiare	30.222.441	90.667.324	260.212.094	94.552.600	475.654.459
Furnitorë dhe detyrime të tjera	1.423.242.643	17.924.219	28.008.443	-	1.469.175.305
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	46,291,495	-	-	-	46,291,495
Të pagueshme ndaj punonjësve	-	8.122.000	-	-	8.122.000
Totali	1,513,498,750	412.153.508	288.220.537	94.552.600	2,308,425,396

5.6 Menaxhimi i riskut të kapitalit

Objektivat e Shoqërisë në menaxhimin e kapitalit janë të ruaje aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar biznesin në vijimesi në mënyrë që të sigurojë përfitime për aksionarët dhe përfitime për palet e tjera të interesuara dhe të mbaje një strukturë optimale kapitali për të reduktuar koston e kapitalit.

5.7 Vlerësimi me vlerë të drejtë

Një numër i politikave kontabël të shoqërisë dhe shënimeve shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare. Drejtimi i Shoqërisë vlerësoi se vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentët të tyre, llogarive të arkëtueshme tregtare, llogaritë e pagueshme tregtare, aktivet dhe detyrimet e tjera afatshkurtra përafrojnë vlerën e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimeve afatshkurtra të këtyre instrumenteve.

6. Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme kontabël

Në aplikimin e politikave kontabël të Shoqërisë, që përshkruhen në Shenimin 3 të këtyre pasqyrave financiare, drejtimit i kërkohet që të bëjë gjykime, çmuarje, dhe supozime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë qartësisht të dukshme nga burimet e tyre. Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto çmuarje.

Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet në çmuarjet kontabël do të njihen në periudhën në të cilën çmuarja është rishikuar nëqoftëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudhat e ardhshme nëqoftëse rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe ato të ardhme.

Garancitë e produkteve

Shoqëria aplikon disa garanci për produktet që tregton. Këto garanci janë si mëposhtë:

a) Garanci standarde

Shoqëria ofron për produktet një garanci standarde që varion nga 12-24 muajsh, për të gjithë klientët e saj. Kjo garanci është e përfshirë në vlerën e produktit për shpenzime të riparimit/zëvendësimit të cilat mbulohen nga furnizuesi i Neptun dhe/ose nga Shoqëria e autorizuar për riparim.

b) Garanci shtesë

Shoqëria gjithashtu ofron garanci shtesë për disa nga produktet që i ofron për klientëve të saj. Këto garanci shiten veçmas nga produkti. Garancia shtesë aplikohet për televizorët, pajisjet e mëdha elektrike dhe pajisjet elektronike (telefona, tableta). Shpenzimet e riparimit/zëvendësimit mbulohen nga furnizuesi i Neptun dhe/ose nga kompania e autorizuar për riparim.

c) Garanci “shkëmbim direkt”

Gjithashtu, Shoqëria ofron një garanci tjetër vetëm për produktet e vogla të kujdesit vetjak (tharëse flokësh, rregullues flokësh, hekur, etj.) të quajtur “shkëmbim direkt”. Garancia “shkëmbim direkt” mbulohet tërësisht nga furnizuesi i produkteve.

6. Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Inventari

Inventari është paraqitur me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Gjatë përcaktimit të vlerës neto të realizueshme drejtimi merr parasysh vjetërsinë e produkteve gjendje në datën e raportimit, produktet e dëmtuara ose të riparuar duke vlerësuar përfitimin nga shitja e tij në rrjedhën normale të biznesit. Në inventar përfshihen të gjitha kostot të lidhura me blerjen, transportin, tarifën doganore dhe sigurimin e mallit. Drejtimi merr parasysh evidencat me objektive dhe të dhënat e disponueshme për kryerjen e këtyre vlerësimeve.

Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, Shoqëria vlerëson nevojën për zhvlerësim të inventarit për produkte të vjetëruara apo produkte të demtuara.

Shuma e zhvlerësimit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse atëhere kur ka faktorë objektive që tregojnë që inventarët janë zhvlerësuar.

Produktet e tregtueshme zhvlerësohen sipas vjetërsisë bazuar në normat e provizionimit të vlerësuar nga grupi në nivel industrie si edhe nga faktorë të ndryshëm në datën e zhvlerësimit.

Produktet gjendje në magazinën e riparimit zhvlerësohen bazuar në mundësinë e kalimit në inventar të tregtueshëm referuar të dhënave historike të dy viteve të fundit të lëvizshmërisë së produkteve në këtë magazinë.

Produktet e vlerësuara si të pa-riparueshme nga kompania e çertifikuar e servisit zhvlerësohen me normën 100%.

Shuma e zhvlerësimit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse atëhere kur ka faktorë objektive që tregojnë që inventarët janë zhvlerësuar.

Përcaktimi i afatit të qirasë së kontratave me mundësi rinovimi dhe përfundimi

Shoqëria ka disa kontrata qiraje që përfshijnë mundësi zgjatjeje të afatit dhe përfundim të kontratës. Shoqëria zbaton gjykimin në vlerësimin nëse ka siguri të arsyeshme që të ushtrojë opsionin për të rinovuar ose përfunduar qiranë. Kjo do të thotë që merr në konsideratë të gjithë faktet dhe rrethanat që krijojnë nxitës ekonomikë për Shoqërinë që të ushtrojë opsionin për zgjatjen e qirasë ose për përfundimin e qirasë. Pas datës së fillimit, Shoqëria rivlerëson afatin e qirasë nëse ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim të rrethanave të cilat janë brenda kontrollit të saj dhe ndikojnë në aftësinë e saj për të ushtruar ose jo mundësinë e rinovimit ose përfundimit.

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

7. Aktive afatgjata materiale

Aktive afatgjata materiale më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si më poshtë:

	Makineri pajisje dhe instalime	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje Zyre	Të tjera aktive afatgjata materiale	Totali
Kosto historike					
Gjendja më 31 dhjetor 2020	223.391.629	61.424.352	290.543.995	31.233.358	606.593.334
Sistemime		5.927.839	(24.538.030)	18.727.684	117.493
Shtesa nga blerja	18.595.143	180.000	14.750.573	9.701.981	43.227.697
Pakësime	-	(14.861.599)	(355.376)	-	(15.216.975)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	241.986.772	52.670.592	280.401.162	59.663.022	634.721.549
Sistemime					
Shtesa nga blerja	20.332.924	4.737.099	30.580.372	9.696.633	65.347.027
Pakësime	(1.746.146)	(8.060.872)	(4.941.981)	(101.829)	(14.850.827)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	260.573.551	49.346.818	306.039.554	69.257.826	685.217.750
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 31 dhjetor 2020	120.887.422	53.679.494	189.019.356	25.510.775	389.097.047
Sistemime	4.274.650	4.820.782	(13.418.899)	4.061.135	(262.332)
Zhvlerësimi i vitit	18.046.929	3.720.767	22.188.098	7.991.922	51.947.716
Pakësime	-	(13.560.455)	(322.112)	-	(13.882.567)
Transferime	-	-	(9.772)	-	(9.772)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	143.209.001	48.660.588	197.456.671	37.563.832	426.890.092
Zhvlerësimi i vitit	18.211.221	1.544.134	22.709.806	8.255.520	50.720.681
Pakësime	(864.263)	(7.848.314)	(4.716.237)	(76.497)	(13.505.310)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	160.555.959	42.356.408	215.450.241	45.742.854	464.105.462
Vlera kontabël neto					
Gjendja më 31 dhjetor 2021	98.777.771	4.010.004	82.944.492	22.099.190	207.831.457
Gjendja më 31 dhjetor 2022	100.017.591	6.990.410	90.589.314	23.514.972	221.112.287

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

8. Aktive afatgjata jo materiale

Aktive afatgjata jo materiale më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si më poshtë:

	Të drejta përdorimi	Sisteme	Të tjera	Total
Kosto historike				
Gjendja më 31 dhjetor 2020	2.354.150	7.401.976	49.848.424	59.604.550
Sistemime	-	(117.492)	-	(117.492)
Shtesa	107.720	404.843	-	512.563
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2.461.870	7.689.327	49.848.424	59.999.621
Shtesa	7.500	623.333	-	630.833
Gjendja më 31 dhjetor 2022	2.469.370	8.312.660	49.848.424	60.630.454
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 31 dhjetor 2020	346.569	107.720	49.848.424	50.302.713
Sistemime	-	262.332	-	262.332
Amortizimi i vitit	235.415	766.252	-	1.001.667
Transferime	-	9.772	-	9.772
Gjendja më 31 dhjetor 2021	581.984	1.146.076	49.848.424	51.576.484
Amortizimi i vitit	246.624	795.405	-	1.042.029
Gjendja më 31 dhjetor 2021	828.608	1.941.481	49.848.424	52.618.513
Vlera kontabël neto				
Vlera 31 dhjetor 2021	1.879.886	6.543.251	-	8.423.137
Vlera 31 dhjetor 2021	1.640.762	6.371.179	-	8.011.941

9. Shpenzime të shtyra afatgjatë

Shpenzimet e shtyra afatgjata më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Shpenzime të shtyra afatgjata në partnerët Franchise	7.828.818	9.173.205
Shpenzime të shtyra afatgjata në partnerët Nova	6.726.090	4.177.872
Garanci per qira	2.323.060	2.031.893
Total	16.877.968	15.382.970

Shpenzime afatgjata të kryera për investime në dyqane në kuadër të bashkëpunimit me partnerët.

10. Të arkëtueshme nga palët e treta

Të arkëtueshme nga palët e treta më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të drejta të arkëtueshme nga klientët	424.359.812	319.538.842
Zhvlerësim për klientë të paarkëtueshëm	(26.183.145)	(21.336.539)
Total	398.176.667	298.202.303

Gjatë 2022, Shoqëria ka fshirë nga të drejta të arkëtueshme vlerën 294,360 Lek (2021: 2,010,279 Lek).

Lëvizja në zhvlerësimin e të drejtave të arkëtueshme është si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Gjendja në fillim të periudhës	21.336.539	19.916.904
Zhvlerësimi	4.846.606	1.419.635
Gjendja në fund të periudhës	26.183.145	21.336.539

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

11. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Gjendje mallrash për rishitje	1.667.396.844	1.646.925.341
<i>Gjendje e mallrave elektroshtëpiake të mëdha</i>	1.278.790.999	1.262.814.246
<i>Gjendje e mallrave elektroshtëpiake të vogla</i>	388.605.845	384.111.095
Zhvlerësim i mallrave	(28.411.856)	(62.223.813)
Materiale të konsumueshme	2.966.843	-
Total	1.641.951.831	1.584.701.528

Materiale te konsumueshme perbehet gjendja e materialeve te konsumueshme dhe nga inventarit te imet.

12. Të arkëtueshme të tjera

Të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Parapagime per furnitorët	17,426,398	7.023.295
TVSH e parapaguar në doganë (a)	9.711.438	12.699.228
Te tjera te arketueshme (b)	32.417.217	25,497,402
Paradhenie per punonjesit	49.500	-
Të drejta për komisionet e financimeve	-	5.035.706
Të drejta për kupona	-	2.545.151
	59.604.552	52.800.782

(a) TVSH e parapaguar ne dogane eshte ne formen e garancise ne lidhje me aktivitetin qe Shoqeria kryen ne dogane gjate vitit.

(b) Te tjera te arketueshme janë rebates qe shoqeria pret te marre nga partneret e furnizimit te mallrave

13. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet të shtyra më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Shpenzime të periudhave të ardhshme	6.875.187	11.836.218
Total	6.875.187	11.836.218

Shpenzime të periudhave të ardhshme përbëjnë shpenzime të faturuara në bazë vjetore të tilla si: shpenzime për karburant, komisione vjetore bankare, sigurim malli për vitin në vijim si dhe nota kreditit të faturuara me vonesë nga furnitorët.

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

14. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Arka		
Arka në Lek	45.765.850	58.411.242
Arka në EUR	6.048.525	5.596.372
Arka në USD	180.915	217.342
	51.995.289	64.224.956
Banka		
Llogari rrjedhesë në Lek	36.350.765	74.240.944
Llogari rrjedhesë në monedhë të huaj	8.833.256	117.175.100
	45.184.021	191.416.044
Të tjera		
Arka në tranzit (Lek)	49.531.145	14.108.998
	49.531.145	14.108.998
Total	146.710.455	269.749.997

Arka në tranzit përfaqëson qarkullimin e fondeve cash që mbledhet në fund të ditës me 31 dhjetor nga pikat e shitjes që kryhet nga një kompani sigurimi e specializuar dhe fondet e likuajuara nga klientët nëpërmjet POS (karta krediti/debiti).

15. Kapitali

Më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 kapitali i autorizuar dhe i regjistruar i Shoqërisë është në vlerën 100.000.000 Lek. Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga ortakët:

- Balfin shpk zotërues i 90% të kuotave, që përbën 90% të kapitalit, në vlerën 90.000.000 Lek;
- Z. Julian Manë zotërues i 10% të kuotave, që përbën 10% të kapitalit, në vlerën 10.000.000 Lek.

Shoqëria ka krijuar ndër vite Rezerva Ligjore në shumën 3.505.722 Lek (31 Dhjetor 2021: 3.505.722 Lek).

16. Aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrime të qirase

E drejta e përdorimit lind në bazë të marrëdhënieve kontraktuale që ka shoqëria për qiramarrjen e ambjenteve për ushtrim të aktivitetit tregtar. Shoqëria ka disa kontrata qiraje që përfshijnë kategoritë në vijim: njësi pika shitjeje, makina, magazina dhe hapësira zyresh administrative. Pjesa më lartë e së drejtës së përdorimit i takon njësive që janë pika shitjeje. Termat e kontratave të qirave është 2-10 vite. Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur lëvizjet dhe njohja e shpenzimeve të amortizimit të të drejtave të përdorimit dhe shpenzimet e interesit për të paraqitur ndikimin e vlerës në kohë të pasasë.

	Pika Shitje	Zyra	Makina	Magazine	Total
E drejta e përdorimit					
Në 1 Janar 2021	586,755,741	29,438,387	28,406,155	79,519,253	724,119,536
Sistemime	(29,480,219)				(29,480,219)
Shtesa	148,210,398	-	30,758,326	86,915,115	265,883,839
Pakësime	-	-	(2,620,455)	(63,658,256)	(66,278,711)
Në 31 dhjetor 2021	705,485,921	29,438,387	56,544,026	102,776,112	894,244,445
Sistemime	(578,258)	-	60,838	(138,965)	(656,384)
Shtesa	497,544,685	-	11,012,553	77,533,351	586,090,590
Pakësime	(247,343,182)	(4,088,836)	(8,221,208)	(10,227,979)	(269,881,205)
Në 31 dhjetor 2022	955,109,166	25,349,551	59,396,209	169,942,519	1,209,797,446
Në 1 Janar 2021	235,433,503	10,284,767	11,172,029	62,412,104	319,302,403
Sistemime	(17,280,144)	-	-	-	(17,280,144)
Amortizimi i vitit	127,783,285	5,107,632	9,155,586	31,927,571	173,974,075

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

Pakësime	-	-	(2,546,258)	(56,687,509)	(59,233,768)
Në 31 dhjetor 2021	345,936,644	15,392,399	17,781,357	37,652,167	416,762,566
Sisteme	(578,258)	-	64,203	(138,965)	(653,019)
Amortizimi i vitit	119,073,121	5,107,632	11,835,641	33,272,337	169,288,732
Pakësime	(226,781,108)	(4,088,836)	(6,430,984)	(6,776,277)	(244,077,204)
Në 31 dhjetor 2022	237,650,400	16,411,195	23,250,218	64,009,262	341,321,075
Vlera kontabël neto					
Vlera 31 dhjetor 2021	359,549,277	14,045,988	38,762,669	65,123,945	477,481,879
Vlera 31 dhjetor 2022	717,458,766	8,938,356	36,145,991	105,933,257	868,476,370

Detyrime për qira

Lëvizja e detyrimeve totale të qirësë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqitet në tabelën si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Vlera kontabël më 1 janar	475.654.459	400.418.990
Pagesat e qirasë	(182.102.644)	(173.096.660)
Interesa	26.067.098	15.184.685
Diferenca nga kursi i kembimit	(41.175.182)	(10.341.989)
Ndryshime gjatë vitit	559.720.605	243.489.433
Total	838.164.337	475.654.459

Detyrimet kontraktuale në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Detyrime afatgjatë për qiranë	656,910,449	354,764,694
Detyrime afatshkurtër për qiranë	181,253,888	120,889,765
Total	838.164.337	475.654.459

17. Huatë nga institucionet financiare

Huatë përbëhen nga detyrimi i Shoqërisë ndaj institucioneve financiare:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Linjë kredie nga Alpha Bank (a)	380.399.963	295.439.965
Overdraft me Alpha Bank	54.167.729	-
Overdraft me Raiffeisen Bank	70.653.821	-
Kredi nga Intesa SanPaolo Bank	-	10.146.976
Kredi nga Raiffeisen Bank	-	3.595.196
Total hua nga institucionet financiare	505.221.513	309.182.137

Aktualisht Shoqëria ka një listë financimesh si më poshtë të mundësuar nga disa institucione bankare në vend:

- (b) **Linjë kredie nga Alpha Bank** - Më 12 Dhjetor 2018, Shoqëria ka nënshkruar një kontratë për kufi kredie shumëqëllimore me bankën Alpha për financimin e një linjë afatshkurtër në vlerën prej 3,600,000 Euro me afat 1-vjekar, e rinovueshme me bazë vjetore. Çdo shumë e disbursuar nga kjo linjë ka afat ripagimi 180 ditë.

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

17. Huatë nga institucionet financiare (vazhdim)

- (c) **Overdraftet** - Shoqëria ka dy linja Overdrafti tek Raiffeisen Bank në vlerat 1,944,558 Euro, 700,000 Euro dhe 300,000 Euro. Shoqëria ka një linjë Overdrafti tek Alpha Bank në vlerën 1,000,000 Euro. Të gjitha marrëveshjet e overdrafteve janë të rinovueshme në bazë vjetore.
- (d) **Garanci bankare** – Shoqëria ka leshuar një garanci bankare në vlerën 300,000 Euro nga Raiffeisen Bank me afat deri në 31 mars 2023 në favor të LG Electronics, një garanci bankare në vlerën prej 400,000 Euro nga banka OTP me afat deri në 26 nentor 2023 në favor të LG Electronics dhe një garanci bankare në vlerën 70,000,000 Lekë nga Raiffeisen Bank në favor të Degës së Doganes Tiranë me afat deri në 30 shtatort 2023. Të gjitha Garancitë Bankare janë të rinovueshme në bazë vjetore.

18. Të pagueshme ndaj paleve te treta

Te pagueshme ndaj paleve te treta më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të pagueshme ndaj furnitorëve te huaj	541.992.880	1.332.459.396
Të pagueshme ndaj furnitorëve vendas	107.166.780	136.715.909
Total	649.159.660	1.469.175.305

Llogaritë të pagueshme ndaj paleve te treta nuk mbartin interes dhe në përgjithësi janë të pagueshme brenda harkut kohor 60-180 ditë. Detyrimet ndaj furnitorëve të mallrave shlyhen në bazë të faturimit.

19. Të pagueshme te tjera

Të pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Parapagime (a)	21.500.477	17.867.352
Furnitor fatura të pambërritur (b)	9.148.665	11.869.135
Shpenzimet e përlogaritur	430.043	3.669.873
Detyrime per kupona (c)	22.386.041	-
Parapagime ndaj palëve të lidhura	3.444.600	1.759.983
Total	56.909.825	35.166.344

- (a) Parapagime përbëhet nga pagesat e kryera nga klientët për produktet që do të duan të blejnë në Neptun.
- (b) Furnitore per fatura te pambërritura lidhen me sherbime te marra por qe fatura nuk eshte marr ende nga furnitori.
- (c) Detyrime per kupona jane kupona te shitur nga Neptun por te paperdorur nga klientet dhe qe priten te perdoren ne vazhdimesi.

20. Të pagueshme ndaj punonjësve

Detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2022 janë në vlerën Lek 13.628.936 (2021: 8.122.000) dhe lidhen me bonuse te perlogaritura.

21. Të pagueshme për detyrimet tatimore

Të pagueshme për detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Detyrim për tatim mbi pagat	3.059.985	2.511.675
TVSH për tu paguar në tatime	88.125.861	44.052.546
Detyrime për tatim në burim	1.158.223	826.868
Detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore	8.894.557	7.215.660
Tatim mbi fitimin i pagueshem	21.933.804	38.838.759
Totali	123.172.430	93.445.508

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

Detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore lidhen me detyrime të cilat janë shlyer gjatë muajit Janar 2023.

22. Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë paraqitur si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga shitja e mallrave	8.219.273.614	7.639.325.541
Mallrave elektroshtëpiake të mëdha	6.681.735.284	6.069.539.751
Mallrave elektroshtëpiake të vogla	1.602.123.337	1.612.714.249
Zbritje nga promocione	(31.255.170)	(13.120.743)
Zbritje Loyalty Program Happy	(33.329.837)	(29.807.716)
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	127.912.795	110.371.073
Të ardhura nga garancitë	65.750.897	50.642.138
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	13.921.699	18.735.420
Të ardhura nga komisionet e ndërmjetësimit	29.385.911	23.850.133
Të ardhura nga komisionet franchise	18.854.288	17.143.382
Totali	8.347.186.409	7.749.696.614

Shoqëria i realizon të ardhurat kryesisht nga shitja e produkteve por edhe shërbimeve.

Të ardhura nga shitja e mallrave përbëhet kryesisht nga pajisje elektroshtëpiake të mëdha dhe të vogla, pajisje elektronike, aksesore të ndryshëm, etj

Të ardhura nga shitja e shërbimeve përbëhet kryesisht nga shërbimet e transportit, montimeve, riparimeve, garanci shërbimi, komisione nga partnerët franchise të cilat janë të ardhura në bazë të shitjeve mujore që realizojnë, si edhe komisione ndërmjetësimi për klientët të cilët përfitojnë pagesa me këste nga institucione të ndryshme të kreditit për produkte të blera në Neptun, etj.

23. Kosto e mallrave të shitur

Kosto e mallrave të shitur për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë paraqitur si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Blerja mallrave	6.989.900.684	6.520.677.587
Zbritje nga blerjet e mallrave	(278.419.162)	(231.918.480)
Zhvleresim inventari	25.687.043	49.213.179
Shërbime doganore	8.032.165	8.746.720
Shpenzimi transporti për mallra	3.175.751	5.780.827
Rimbursim Loyalty Program	(10.959.953)	(6.368.454)
Total	6.737.416.528	6.346.131.379

Zbritje nga blerjet e mallrave përbëhet nga zbritjet e furnitorëve për mallra sipas arritjeve në volume të blerjeve sipas periudhave të caktuara (mujore, 3-mujore, vjetore), kompesime në cmimet e produkteve gjatë ofertave të ndryshme, për pagesa në kohë, produkte të dëmtuara brenda garancisë dhe gjatë transportit, etj Bazuar në Loyalty Program, On Solution shpk ("Banker") rimbursion anëtarët për kuponat e përdorur nga klientët në dyqanet e tyre (Per reference pika 3.8 e Politikave Kontabël të Rëndësishme)

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

24. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë paraqitur si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata	869.227	404.643
Të ardhura të tjera	23.276.631	11.470.472
Totali	24.145.858	11.875.115

Të ardhura të tjera janë kryesisht shërbime të ndryshme konsulence dhe të ardhura të tjera.

25. Pagat dhe shpenzimet e personelit

Pagat dhe shpenzimet e personelit për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë paraqitur si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Pagat e punonjësve	298.023.339	261.283.013
Shpenzime për shpërblime	69.504.538	49.432.087
Sigurimet Shëndetësore e Shoqërore	51.352.266	43.736.725
Totali	418.880.143	354.451.825

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

26. Shpenzime operative

Shpenzime operative për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë paraqitur si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shërbime mirembajtje sisteme, konsulencë etj	99.837.116	76.654.370
Reklame, publicitet	80.927.014	59.989.621
Ambjente të përbashkëta	41.494.689	35.685.503
Transferime, udhëtim, dieta	40.804.955	36.714.534
Blerje energji, ujë	39.646.361	36.142.765
Shpenzime për karburant	24.682.440	18.714.000
Shërbime bankare	17.216.739	11.995.452
Shpenzim roje	16.058.785	16.641.595
Shpenzime administrative	11.912.434	10.926.842
Shpenzime për pritje, dhurata dhe sponsorizime	11.020.000	8.235.183
Personeli jashtë njësisë	7.469.640	7.064.406
Per riparim makinash	6.704.488	5.509.923
Kancelari	5.085.791	4.787.813
Zhvleresimi për llogaritë e arketueshme	4.846.606	1.419.635
Shpenzime postare e telekomunikacioni	4.575.434	6.011.424
Mirëmbajtje dhe riparime	4.521.368	4.904.389
Taksa vendore	4.293.252	4.956.115
Pastrimi	3.422.319	3.172.405
Shpenzime trajnimi	2.763.471	2.565.138
Polica Sigurimi	2.534.673	1.820.834
Shpenzime të tjera të personelit	2.473.309	1.685.578
Shpenzime rekrutimi	1.228.714	1.427.291
Penalitete, gjoba, dëmshpërblime	948.127	2.497.874
Te tjera	4.477.587	-
Fshirje e të drejtave te arketueshme	294.360	9.959.105
Qira	-	1.682.215
Totali	439.239.672	371.164.010

Shërbime mirembajtje sisteme, konsulencë përfshijnë dhe shërbimet e auditimit ligjor te pasqyrave financiare në shumën prej 1.580.085 Lek për vitin 2022 nga Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar, Dega në Shqipëri. Shoqëria nuk ka marrë shërbime të tjera sigurie apo jo auditu nga Ernst & Young.

27. Amortizime dhe zhvleresime

Amortizime dhe zhvleresime për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë paraqitur si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Amortizimi dhe zhvleresimi	54.294.659	54.664.003
Zhvleresimi i të drejtave në përdorim (SNRF16)	169.288.732	173.974.074
Totali	223.583.390	228.638.077

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

28. Shpenzime financiare, neto

Shpenzime financiare, neto për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë paraqitur si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime interesa BG LC	(6.066.896)	(7.503.294)
Shpenzime Interesa OVD, kredi	(17.059.408)	(15.088.630)
Shpenzime për interesa SNRF16	(26,067,098)	(15.184.685)
Të ardhura nga interesi	112	1.056
Shpenzime për interesa me palët e lidhura	(11.961.469)	(12.536.212)
Totali	(61.154.759)	(50.311.765)

29. Fitim/(humbje) nga këmbimet valutore, neto

Fitim/(humbje) nga këmbimet valutore, neto për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë paraqitur si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Fitimi nga kursi i këmbimit	215,406,788	77.933.835
Humbje nga kursi i këmbimit	(47.018.548)	(11.968.224)
Totali	168.388.240	65.965.611

30. Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për vitet që mbyllen më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 është si më poshtë:

	2022	2021
Fitimi përpara tatimit	659.446.014	476.840.283
Rregullime	30.806.033	83.444.191
Shpenzime të pazbritshme	26.019.362	20.048.555
Shpenzimet e pazbritshme nga zhleresimet e inventarit	25.687.043	49.213.179
Shpenzim/provigjion për llogari të arkëtueshme	4.846.606	1.419.635
Fshirje e të drejtave e detyrimeve	294.360	9.959.105
Rimarrje provigjioni per programin e besnikërisë	-	(5.531.385)
Shpenzime të pazbritshme SNRF 16	(28.524.955)	5.352.879
Shpenzime të pazbritshme PPE	2.483.617	2.982.223
Fitimi i tatueshem	690.252.047	560.284.474
Shpenzimi për tatim fitimin me normen 15%	103.537.807	84.042.671

Shpenzimet e pazbritshme për efekt tatimor përmbajnë kryesisht faturimet e shpenzimeve të utiliteteve kontratat e të cilave nuk janë kaluar në emër të shoqërisë Neptun, si pasojë nuk mund të konsiderohen si shpenzime të zbritshme në llogaritjen e tatim fitimit vjetor të Shoqërisë. Gjithashtu përfshihet dhe efekti i amortizimit të aktiveve me të drejtë përdorimi etj. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme, shpenzime të ndryshme pa dokumentacion fiskal, diferenca që vjen nga pagesat e qirave me rregullimet kontabël për efekt të njohjes së SNRF16. Norma aktuale e tatimit për vitin 2022 është 15% (2021: 15%). Tatim fitimi i llogaritur për vitin 2022 është 99.592.419 Lek (2021: 84.042.671 Lek).

Trajtime të pasigurta të tatimit mbi të ardhurat

Detyrimet aktuale të tatimit mbi fitimin nuk përfshijnë shuma që lidhen me zbritje të pasigurta tatimore të ndonjë shpenzimi. Drejtimi vlereson se nuk do të ketë ndonjë ekspozim të mundshëm që do të kërkojë shlyerje të mundshme në rast të pretendimeve nga autoritetet tatimore. Detyrimet e tatimit mbi të ardhurat do të vleresohen plotësisht kur të kryhen kontrole tatimore në lidhje me deklaratimet përkatëse tatimore.

NEPTUN Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

(Vlerat ne Lek)

31. Transaksione me palet e lidhura

Tabela më poshtë përmbledh gjendjet nga transaksionet me palet e lidhura:

31 dhjetor 2022	Furnitorë Detyrime te pagueshme	Te drejta te arketueshme	Të ardhura nga shitja e mallra e sherbime	Te ardhura te tjera	Shpenzime operative e te tjera	Shpenzime per interesa
Shoqeria meme	(532.017.811)	9.891.181	(127.261.107)	(3.685.799)	2.642.346.583	12.736.226
Shoqeri simotra	(1.658.138)	1.105.759	(7.991.784)	(735.634)	38.034.924	8.035.900
Totali	(530.359.673)	8.785.422	(119.269.323)	(2.950.165)	2.604.311.659	4.700.326

31 dhjetor 2021	Furnitorë Detyrime te pagueshme	Te drejta te arketueshme	Të ardhura nga shitja e mallra e sherbime	Te ardhura te tjera	Shpenzime operative e te tjera	Shpenzime per interesa
Shoqeria meme	46,291,495	6.930.311	(65.915.365)	(3.750.168)	93.330.856	13.970.045
Shoqeri simotra	-	957	(4.775.964)	(51)	27.832.360	8.348.531
Totali	46,291,495	6.930.311	(65.915.365)	(3.750.168)	93.330.856	13.970.045

Kompensimi për Drejtimin e Lartë me 31 dhjetor 2022 është në vlerën 19,071,460 Lek (2021: 19,400,979).

32. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shenimet shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulet. Aktivët e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shenimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjonin. Një detyrim njihet në datën e pasqyrës e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

33. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime ose informacione shpjeguese shtesë në këto pasqyra financiare.